



DREJTORIA E  
PËRGJITHSHME  
E DOGANAVE

# Administrata Doganore Shqiptare

dogana.shqiptare Dogana Shqiptare

Newsletter | Prill 2026

## DREJTORI I DOGANAVE NË KONFERENCËN E OBD PËR RAJONIN E EUROPËS

Me ftesë të Organizatës Botërore të Doganave dhe Autoriteteve Doganore të Mbretërisë së Bashkuar (HMRC-HM Revenue & Customs), Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Besmir Beja, mori pjesë në Takimin Vjetor të Drejtuesve të Doganave të rajonit të Europës, që zhvillohet në Bruksel. Z. Beja, zhvilloi një takim të veçantë me Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës Botërore të Doganave, z. Ian Saunders. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi forcimin e bashkëpunimit ndërmjet Administratës Doganore Shqiptare dhe Organizatës Botërore të Doganave, me fokus në mbështetjen për proceset modernizuese, zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe përshejtimin e digjitalizimit të shërbimeve doganore.



## DIALOG I HAPUR ME BIZNESET AUSTRIAKE

U zhvillua në Tiranë Forumi Dogana-Biznes me përfaqësues të sipërmarrjeve austriake që operojnë në Shqipëri, një platformë e rëndësishme dialogu mes Administratës Doganore dhe komunitetit të biznesit. Forumi kishte në fokus forcimin e bashkëpunimit, lehtësimin e tregtisë dhe përshejtimin e reformave drejt integritimit evropian.

Drejtori i Përgjithshëm, z. Beja, rikonfirmoi angazhimin e Administratës Doganore si një partner i besueshëm i biznesit në procesin drejt standardeve evropiane, si dhe prezantoi vizionin për transformimin e plotë digjital dhe institucional të doganave shqiptare, duke theksuar rolin e Inteljencës Artificiale në rritjen e efikasitetit dhe saktësisë së kontrollit.



## PRISHTINË, TAKIM ME DREJTORIN E DOGANAVE AGRON LLUGALIU

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Besmir Beja, zhvilloi një takim me Dregjtorin e Doganave të Kosovës, Agron Llugaliu, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet dy administratave doganore.

Gjatë diskutimeve u evidentua rëndësia e lehtësimin të mëtejshëm të tregtisë dhe procedurave doganore, duke u ndalur veçanërisht te roli i zyrave të Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit dhe Porto Romano, të cilat kanë kontribuar në përshejtimin e përpunimit të mallrave dhe uljen e kostove për operatorët ekonomikë.



## BLOKOHEN MALLRA TË DYSHUARA PËR CENIM TË MARKAVE TREGTARE

Administrata Doganore vijon kontrollin në kuadër të luftës kundër informalitetit dhe mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale. Gjatë një kontrolli fizik të ushtruar në Degën Doganore Kakavijë, strukturat doganore, në bashkëpunim me njësitë e Antikontarbandës, kanë konstatuar dhe bllokuar një sasi prej rreth 1500 palë atlete, të dyshuara për cenim të markës tregtare New Balance. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave mbetet e angazhuar për forcimin e kontrolleve, garantimin e konkurrencës së ndershme dhe respektimin e legjislacionit në fuqi në fushën e tregtisë dhe të drejtave të pronësisë intelektuale.



## NIKO ÇILI, 40 VITE PËRKUSHTIM NË SHËRBIM TË DOGANËS SHQIPTARE

Administrata Doganore Shqiptare vlerësoi një prej figurave më të spikaturave të saj, z. Niko Çili, i cili shënoi plot 40 vite shërbim të përkushtuar në këtë institucion. Karriera e tij, e nisur në vitin 1986 në Administratën Doganore Shqiptare, përkon me disa prej momenteve më të rëndësishme të historisë së Doganës Shqiptare.

Nga angazhimet e hershme në degën Doganore të Rinast, tek pjesëmarrja në delegacionin shqiptar në Organizatën Botërore të Doganave në vitin 1993, e deri te kontributi në periudha kyçe si miratimi i Kodit Doganor të vitit 1999, e më tej ai i përfutur me legjislacionin e BE në vitin 2014, rrugëtimi i tij profesional përbën një dëshmi të drejtpërdrejtë të zhvillimit të institucionit ndër vite. Prej 26 vitesh, z. Çili ka ushtruar detyrën e këshilltarit të Drejtorit të Përgjithshëm, duke shërbyer me përkushtim pranë të gjithë drejtuesve të institucionit në këtë periudhë.

## VIZITË NË DEGËN DOGANORE HANI I HOTIT

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Besmir Beja, së bashku me ministrin e Financave, z. Petrit Malaj, zhvilluan një vizitë në pikën doganore Hani i Hotit, e cila është një nga pikat doganore më të rëndësishme të vendit tonë dhe kryesore tregtare drejt tregjeve evropiane. Gjatë vizitës, ata u njohën nga afër me aktivitetin e përditshëm të degës doganore, procesin e përpunimit të deklaratave doganore dhe masat që po merren për lehtësimin e skanimit të mallrave dhe mjeteve, me qëllim rritjen e sigurtisë, shpejtësisë së përpunimit dhe transpar-



## BASHKËPUNIM PËR MODERNIZIMIN E ADMINISTRATËS DOGANORE

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Besmir Beja, zhvilloi një takim me drejtuesen e projektit RegioTrade, znj. Tanja Bosković, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dhe mbështetjes për Administratën Doganore Shqiptare. Në takim morën pjesë gjithashtu znj. Sonja Kurz, Drejtore e Zyrës së GIZ në Shqipëri, si dhe znj. Eranda Begaj, Koordinatorë e vendit për Fondin Rajonal të Hapur për Tregtinë e Jashtme dhe Menaxhere Projekti në Zyrën e Tiranës.

Qëllimi i takimit ishte prezantimi dhe koordinimi i mëtejshëm i nismave në mbështetje të Administratës Doganore Shqiptare, si dhe diskutimi mbi prioritetet aktuale dhe forcimi i bashkëpunimit me projektet RegioTrade dhe GIZ. Ky bashkëpunim ka ndikuar në përmirësimin e efikasitetit operacional dhe në përafrimin e mëtejshëm me standardet e Bashkimit Evropian, përmes mbështetjes në fusha si procedurat elektronike, kontrolli i bazarit në risk dhe thjeshtimi i procedurave doganore.



## TAKIM ME AMBASADORIN E MBRETËRISË SË HOLANDËS

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, zhvilloi një takim me Ambasadorin e Mbretërisë së Holandës në Tiranë, Reinout Vos, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dypalësh dhe thellimit të marrëdhënieve ekonomike mes dy vendeve.

Gjatë takimit, palët vlerësuan nivelin shumë të mirë të bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Holandës, veçanërisht në drejtim të shkëmbimeve tregtare dhe theksuan rolin e rëndësishëm që ka Administrata Doganore në lehtësimin e tregtisë së ligjshme, rritjen e transparencës dhe krijimin e një klime të favorshme për investimet e huaja.



DREJTORIA E  
PËRGJITHSHME  
E DOGANAVE

# Administrata Doganore Shqiptare

dogana.shqiptare Dogana Shqiptare

Newsletter | Prill 2026



## TAKIM TEKNIK SHQIPËRI-GREQË

Administrata Doganore Shqiptare zhvilloi në Athinë takimin teknik dypalësh me palën greke, në kuadër të zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë. Takimi u organizua në selinë e Autoritetit të Pavarur të Ardhurave Publike, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të administratave doganore të të dy vendeve dhe Sekretariatit të CEFTA-s, në vijim të bashkëpunimit të vendosur në kuadër të nismës "Green Lanes". Palët diskutuan mbi hapat e mëtejshëm dhe veprimet konkrete që duhet të ndërmerren për vijimin e zbatimit të marrëveshjes, me synim rritjen e efikasitetit të kontrolleve, forcimin e bashkëpunimit teknik dhe përmirësimin e lehtësirave për tregtinë ndërkufitare. Kjo marrëveshje përbën një hap konkret drejt modernizimit të bashkëpunimit doganor mes Shqipërisë dhe Greqisë, duke përshpejtuar procedurat kufitare dhe duke i përfruar ato me standardet evropiane, në funksion të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

## VIZITË NË DEGËN DOGANORE SARANDË

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Besmir Beja, prezantoi drejtuesin e ri të Degës Doganore Sarandë, Ervis Mehmeti. Gjatë prezantimit, ai u ndal te rëndësia e forcimit të mëtejshëm të punës në këtë pikë doganore, duke theksuar se përvoja e mëparshme e z. Mehmeti në administratën doganore përbën një bazë të rëndësishme për përmbushjen e detyrave në vijim.

Në komunikimin me stafin, ai kërkoi vijimësi në standardet e punës, respektim të procedurave dhe bashkëpunim të ngushtë mes strukturave, me synim garantimin e një shërbimi sa më efikas dhe funksional.



## DREJTORI I PËRGJITHSHËM NË DOGANËN E VLORËS

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, zhvilloi një vizitë pune në Doganën e Vlorës, në kuadër të monitorimit në terren të funksionimit të strukturave doganore dhe forcimit të standardeve të shërbimit. Gjatë vizitës, Drejtori i Përgjithshëm u njoh nga afër me ecurinë e proceseve operacionale, menaxhimin e flukseve dhe zbatimin e procedurave doganore në këtë pikë të rëndësishme për aktivitetin ekonomik dhe tregtar në jug të vendit. Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rolit të Doganës në garantimin e sigurisë dhe lehtësimit të tregtisë.



## VIZITË NË DEGËN DOGANORE TË KAKAVIJËS

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, Besmir Beja, zhvilloi një vizitë pune në Degën Doganore të Kakavijës, në kuadër të monitorimit të drejtpërdrejtë të funksionimit të strukturave në terren dhe forcimit të mëtejshëm të standardeve të shërbimit.

Gjatë vizitës, Drejtori i Përgjithshëm u njoh nga afër me ecurinë e procedurave doganore, menaxhimin e fluksit të udhëtarëve dhe mallrave, si dhe masat e marra për garantimin e sigurisë dhe lehtësimin e lëvizjes në këtë pikë të rëndësishme kufitare. Ai theksoi rëndësinë e rritjes së efikasitetit operacional dhe përmirësimin të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve dhe biznesit.



## NË KONFERENCËN E RRJETIT BALLKANIK PËR MBROJTJEN E EUROS

Përfaqësues të Administratës Doganore morën pjesë në Konferencën e 6-të të Rrjetit Ballkanik për Mbrojtjen e Euros (Balkan Network for Euro Protection), e zhvilluar në Dubrovnik, Kroaci.

Ky aktivitet rajonal mbledhi ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve financiare, autoriteteve ligjzbatuese dhe strukturave doganore nga vendet e rajonit dhe më gjerë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër falsifikimit të monedhës dhe mbrojtjen e integritetit të euros.



## BASHKËPUNIM MES SHQIPËRISË DHE GJEOGJISË

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, z. Përfaqësues të Administratës Doganore Shqiptare zhvilluan një vizitë pune pranë Shërbimit të të Ardhurave të Ministrisë së Financave të Gjeorgjisë, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shkëmbimit të eksperiencave në fushën doganore.

Gjatë takimit, palët diskutuan mbi sfidat aktuale në administrimin doganor, si dhe mbi mundësitë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit mes dy vendeve, me fokus në modernizimin e procedurave, lehtësimin e tregtisë dhe rritjen e efikasitetit operacional. Kjo vizitë shërben si një hap i rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve dypalëshe dhe në promovimin e praktikave më të mira në administrimin doganor.



## RRITEN KONTROLLET NDAJ MATERIALEVE RADIOAKTIVE

Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me Programin NSDD të Departamentit të Energjisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, u zhvillua vizita periodike monitoruese pranë Degës Doganore të Hanit të Hotit, me fokus forcimin e kapaciteteve për zbulimin dhe parandalimin e kontrabandës së materialeve radioaktive.

Gjatë aktivitetit, vëmendje e veçantë iu kushtua funksionimit në terren të sistemit të lëvizshëm të detektimit të radioaktivitetit (Mobile Detection System - MDS), një mjet i avancuar teknologjik që mundëson identifikimin në kohë reale të pranisë së materialeve radioaktive në mjete transporti, ngarkesa apo ambiente të ndryshme.



## TRAJNIM PËR FORCIMIN E HETIMEVE FINANCIARE PROAKTIVE

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave mori pjesë në trajnimin me temë "Forcimi i Agjencive Ligjzbatuese për gjurmimin e flukseve financiare përmes hetimeve financiare proaktive dhe paralele". Trajnimi u zhvillua në kuadër të projektit "EU for Law Enforcement in Albania (EU4LEA II)", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Trajnimi u drejtua nga ekspertë ndërkombëtarë dhe oficerë të lartë të Guardia di Finanza, të cilët ndanë përvojën e tyre praktike përmes rasteve studimore dhe shembujve operacionalë, duke sjellë modele konkrete të hetimeve financiare në nivel evropian.

## TAKIMI I GRUPEVE TË PUNËS TË CEFTA PËR AEO

Më 21-22 prill 2026, në Chisinau, Moldavi, u zhvillua takimi i grupeve të punës të CEFTA-s për Operatorët Ekonomikë të Autorizuar (AEO) dhe menaxhimin e riskut, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të administratave doganore të rajonit dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Diskutimet u fokusuan në ecurinë e programeve AEO dhe zbatimin e strategjive të menaxhimit të riskut, duke nxjerrë në pah sfidat dhe mundësitë për zhvillim të mëtejshëm. Një vëmendje e veçantë iu kushtua koordinimit mes këtyre dy komponentëve, me theks te rëndësia e një qasjeje të integruar për rritjen e efikasitetit të kontrolleve dhe lehtësimin e tregtisë së ligjshme.